

VENDIM
Nr.588, datë 28.8.2003

PËR PAGËN MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5. 1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paga bazë minimale, mujore për punonjësit në shkallë vendi, e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 10 060 (dhjetë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

2. Vendimi nr.307, datë 27.6.2002 i Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano